



# GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES SË NXËNËSVE  
NË FUND TË CIKLIT TË TRETË TË SHKOLLËS FILLORE

MAJ, VITIT MËSIMOR 2016/2017

## UDHËZIM

Koha për zgjidhjen e testit është **70 minuta**.

Mos e hapni testin dhe mos filloni t'i zgjidhni detyrat derisa të mos ju japë leje mësimdhënësi kujdestar.

Testi **DUHET** të jetë i shkruar me laps kimik ose me stilolaps.

Shkruani lexueshëm me shkronja dore.

Nëse shkruani me shkronja shtypi, theksojeni shkronjën e madhe aty ku duhet të jetë. Respekto rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore. Nëse mendon se ke gabuar me rastin e zgjidhjes së detyrës, vendos një vijë të kryqëzuar (X) mbi të dhe zgjidhe përsëri.

**Nuk guxon të përdorësh korrektorin.**

Detyrat nuk e ke për detyrë t'i zgjidhësh me rend ashtu siç janë dhënë në test.

Nëse e përfundon punën më parë, kontrolloji edhe një herë zgjidhjet tua.

**Detyra do të vlerësohet me zero (0) pikë nëse:**

- është e pasaktë
- është e palexueshme dhe nuk është shkruar qartë përgjigjja
- është e shkruar me laps të thjeshtë
- është shkruar ose qarkuar edhe përgjigjja e saktë dhe e pasaktë

**ME FAT!**

**SHIFRA E NXËNËSIT**



# FAQJA E ZBRAZËT

Shikoje tekstin i cili ndodhet në anën e prapme të llogarisë fiskale pastaj zhvilloji detyrat 1, 2 dhe 3.

# SUPERMARKETET FRANCA

1 x Fiat Punto

10 x verime për dy persona 7 ditë

5 x biçikleta

5 x televizorë

5 x telefona

100 x 25€ pako dhuratë me prodhimet Franca

Të drejtë pjesëmarrjeje në lojën shpërblyese kanë konsumatorët të cilët tregtojnë në marketet Franca në një shumë më të madhe se 7€, dhe me atë rast blejnë një ose më shumë prodhime nga brendet e shënuara.



POLIMARK

Nestlé

head & shoulders

Pampers

Mosta Proper

FRANCA

Emri \_\_\_\_\_

Mbiemri \_\_\_\_\_

Telefoni \_\_\_\_\_

**1. Cili është qëllimi i tekstit të dhënë?**

1. Që të njoftojë blerësit për lojën shpërblyese.
2. Që të shërbejë për pjesëmarrje në lojën shpërblyese.
3. Që ta reklamojë lojën shpërblyese.

*Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë.*

1 pikë	
--------	--

**2. Që të fitojë të drejtë që të marr pjesë në lojën shpërblyese, blerësi duhet t'i plotësojë dy kushte. Shënoji ato.**

KUSHTI I \_\_\_\_\_

KUSHTI II \_\_\_\_\_

1 pikë	
--------	--

**3. Përse është i domosdoshëm numri i telefonit të blerësit?**

\_\_\_\_\_

1 pikë	
--------	--

## Lexoji fragmentet nga teksti “Dreka” të Somerset Momo pastaj zhvilloji detyrat 4, 5, 6, 7 dhe 8.

Më ra në sy gjatë shfaqjes dhe në shenjën që më dha me dorë shkova, gjatë pauzës, dhe u ula pranë saj. Kaloi një kohë e gjatë nga takimi ynë i fundit dhe, sikurse të mos e përmendte dikush emrin e saj, nuk besoj se e kisha njohur fare. Më është drejtuar e gëzuar:

– Eh, shumë vjet kanë kaluar ngaqë jemi njohur. (...) A ju kujtohet kur ju pash për herë të parë? Më keni ftuar në drekë.

Ishte kjo para njëzet vjetësh dhe unë jetoja në Paris. Kam pasur në Lagjen Latine një banesë të vogël, me shikim në varreza, dhe fitoja aq para sa mezi ta mbaja disi shpirtin në trup. (...)

...a do ta merrja me veten në gosti tek „Fojo-ja“? „Fojo“ ishte një restorant në të cilin ushqeheshin senatorët francez dhe aq i kalonte mundësitë e mija saqë askurrë nuk më kishte shkuar ndërmend të shkoja atje.

Nuk e ndjeva veten mirë kur e sollën menynë, sepse çmimet ishin shumë më të mëdha sesa prisja. Por, ajo as që çante kokën për këtë:

– Unë kurrë nuk ha gjë për drekë – tha menjëherë.

– Oh, jo vallë! U përgjigja me një zemërgjerësi.

– Asnjëherë nuk marr më tepër se një ushqim. Sipas mendimit tim, njerëzit sot hanë shumë. Do të mund të haja një peshk, për shembull. Më intereson nëse kanë salmon.

E po mirë, salmoni ende nuk e kishte kohën dhe nuk gjendej në meny, megjithatë unë e pyeta kamarierin nëse e kanë këtë lloj peshkut. Po, po, tamam ka mbërritur një salmon i jashtëzakonshëm, të parin që e kishin marr fare. E porosita për mysafiren time. Kamarieri e pyeti nëse dëshiron diçka të brej derisa të përgatitet peshku.

– Jo – u përgjigj ajo – asnjëherë nuk ha më shumë se një ushqim... vetëm nëse keni havjar. Nuk kam asgjë kundër havjarit.

Zemra ime u ngushtua pak. E kam ditur se nuk mund t’i lejoj vetes që të porosis havjar, por nuk mundesha t’ia them krejt ashtu. I thash kamarierit që patjetër ta sjell havjarin. Për veten zgjodha ushqimin më të lirë nga menya; (...)

Ajo e hëngri havjarin, dhe pastaj e hëngri edhe salmonin. U ngjall biseda për pikturën, letërsinë, muzikën. Por, unë pyetesha se sa do të jetë llogaria. (...)

– Jo, jo, asnjëherë nuk ha gjë për drekë, por një kafshatë, askurrë nuk kërkoj më shumë, dhe këtë, kryesisht, të kem një arsytim për bisedë. Nuk mundem asgjë tjetër të vë në gojë... vetëm nëse keni ndonjë shpargull të madh.

Zemra ime përsëri u ngushtua. Kam parë shparguj nëpër shitore dhe e kam ditur se janë tmerrësisht të shtrenjtë. Uji më ka rrjedhur nëpër gojë derisa i shikoja. (...)

U shfaqen shpargujt. Ishin me të vërtetë të mëdhenj, të lëngshëm dhe tërheqës. Era e gjalpjit të shkrirë m’i guduliste vrimat e hundës. E shikoja atë grua të shfrenuar se si i kapërdinte shpargujt me kafshata të mëdha dhe lakmuese dhe me këtë rast flisja me një mirësjellje për gjendjen e dramës në Ballkan.

Më në fund përfundoi me të ngrënit.

– E do një kafe – i thash.

– Po, vetëm një akullorë dhe një kafe – u përgjigj ajo. (...)

Megjithatë, unë në fund mora një kënaqësi. Nuk do të them se jam hakmarrës për nga natyra, mirëpo kur perënditë e pavdekshëm e marrin punën në duart e veta, mund të na falet nëse me kënaqësi e shikojmë rezultatin e saj. Ajo grua sot peshon njëqind e tridhjetë kilogram.

### 4. Caktoje vendin/vendet e ngjarjes në tekst.

1 pikë

### 5. Për çfarë kanë biseduar rrëfyesi dhe mysafirja e saj?

1 pikë

**6.** A) Mënyra e rrëfimit në këtë tekst është:

1. kronologjike
2. retrospektive

*Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë.*

1 pikë

**B) Argumentoje përgjigjen.**

1 pikë

**7.** Përshkruaji dy fjali (pjesë të fjalive) të cilat tregojnë veprimet që pikturojnë përjetimet e brendshme të rrëfyesit.

1 pikë

**8.** A) Emëroji pjesët e fabulës.

1. Ishte kjo para njëzet vjetësh dhe unë jetoja në Paris. Kam pasur në Lagjen Latine një banesë të vogël, me shikim në varreza, dhe fitoja aq para sa mezi ta mbaja disi shpirtin në trup.
2. – Unë kurrë nuk ha gjë për drekë – tha menjëherë.  
– Oh, jo vallë! U përgjigja me një zemërgjerësi.  
– Asnjëherë nuk marr më tepër se një ushqim. Sipas mendimit tim, njerëzit sot hanë shumë. Do të mund të haja një peshk, për shembull. Më intereson nëse kanë salmon.

1 pikë

**B) Nga teksti përshkruaje fjalinë e cila tregon zgjidhjen.**

1 pikë

**9.** "Unë do të gëzohem më shumë se ju..."

**A) Në cilën kohë është përdorur folja e nënvizuar?**

\_\_\_\_\_

1 pikë

**B) Folja e nënvizuar është përdorur në mënyrën:**

\_\_\_\_\_

1 pikë

**10.** **A) Rrethoje numrin para fjalisë në të cilën viza është përdorur drejtë.**

1. Nëse fitojmë 5 për-qind janë tuat.
2. Bileta vajtje-ardhje është më e lirë.
3. Kam lexuar vetëm kapitullin XIX-të.

*Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë.*

1 pikë

**B) Argumentoje përgjigjen.**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

1 pikë

**11.** Në vendin e lënë bosh shkruaje shkronjën përkatëse në mënyrë që fjala të jetë e shkruar saktë.

sta\_\_\_ionim      stërho\_\_\_oj      \_\_\_ezmë

standar\_\_\_izoj      drug\_\_\_endës

2 pikë



**12.** Lexoje fjalinë e mëposhtme dhe plotësoje tabelën me përgjigjet e kërkuara për funksionin sintaksor që kryejnë fjalët e nënvizuara në këtë fjali.

Ai dinte gjithçka dhe ishte i gatshëm të më shpjegonte gjithçka..

gjithçka	
ishte i gatshëm	

2 pikë

**13.** Fjalët nga kllapat përdori në rasën e duhur.

1. Posa erdhi në shkollë filloi të \_\_\_\_\_ me shokë. (përlaj)
2. E kemi parë mbi \_\_\_\_\_ e shtëpisë. (pullaz)
3. Po as ti nuk u ndihmon \_\_\_\_\_ për të mësuar. (ata)

2 pikë

**14.** Në tabelën e mëposhtme shëno pjesët e ligjëratës që i takojnë fjalët e fjalisë së dhënë.

Libri i vogël ndodhet mbi tavolinë.

<i>Libri</i>	<i>i vogël</i>	<i>ndodhet</i>	<i>mbi</i>	<i>tavolinë</i>

1 pikë

**15.** “Tani, zgjidh dhuratën që të pëlqen më shumë dhe martohu me princin që e ka sjellë”  
- i tha mbreti së bijës.”

Kthejeni fjalinë e dhënë nga ligjërata e zhdrejtë në ligjëratën e drejtë.

1 pikë

**16. Pranë fragmenteve nga tekstet shëno cilit stil funksional i përket.**

1. Era e fortë ushtonte dhe fishkëllente në mes të rrotave të vagonëve dhe në mes të trarëve prapa stacionit. Vagonët, shtyllat, njerëzit, gjithçka që mund të shikohej, nga njëra anë ishte e mbuluar me borë e cila binte gjithnjë e më tepër. Për një moment stuhia e borës pushoi, pastaj përsëri filloi me të njëjtën fuqi, saqë dukej se: nuk mund t'i përballohej.
- 

2. Është e pamundur për të bërë një motor të përjetshëm (perpetum mobile) të llojit të parë domethënë një pajisje e cila me përsëritjen e ciklit do ta kryente punën pa marrjen e nxehtësisë (ose të një forme tjetër të energjisë) nga një trup tjetër.
- 

3. Ekspozita e njohur botërore Dinozaurët e Argjentinës: Viganët e Patagonisë do të mbahet në sallat e Panairit të Adriatikut në Budva në periudhën nga 1 qershori deri më 31 gusht. Ekspozita përbëhet nga 25 replika unike dhe origjinale të dinozaurëve.
- 

3 pikë	
--------	--

**17. Pranë emrit të personazhit letrar shkruaje titullin e veprës në të cilën paraqitet si dhe emrin dhe mbiemrin e autorit të saj.**

Princ Rogani \_\_\_\_\_

Marga \_\_\_\_\_

Tana \_\_\_\_\_

3 pikë	
--------	--

**Lexoji me kujdes disa strofa nga poezitë *Syrgjyn vdekur* (e Fan Nolit) dhe *Një mendim më turbullon* (e Shandor Petefit) pastaj përgjigju në pyetjet 18 dhe 19.**

**SYRGJYN VDEKUR**

ëno moj, mbaj zinë për vëllanë  
Me tre plumba na i ranë,  
Na e vran' e na e shanë,  
Na i thanë tradhëtor.

Se të deshte kur s'të deshnin  
Se të qante kur të qeshnin,  
Se të vishte kur të zhveshnin  
Nëno moj, të ra dëshmor.

Nëno moj, vajto, merr malin,  
Larot ta përmbysnë djaln  
Që me Ismail Qemalin  
Ngriti flamur trimëror.

.....

*Fan Noli*

**NJË MENDIM MË TURBULLON**

Mendimi i egër gjithë më bren:  
mos vdekja gjë në shtrat më gjen,  
e ngaj si lulja që s'ka fletë,  
që krimbi atë e bren ngadalë,  
ose, braktisur në një llome të shkretë  
venitem si kandil që s'ka vaj!  
Ah s'dua jo, kështu të vdes,  
mos, mos, o zot, më pre çdo shpresë!

Dua të jem një lis, që i kanosen  
rrufet' e shqotat, që mbi të marrosen,  
ose një shkëmb, që kur gremiset,  
të duket se dhe qielli po përmbysset...

.....

*Shandor Petefi*

**Fjalët e panjohura:**

**Syrgjyn:** i internuar, i mërguar

**Laro:** njeri i pabesë e tradhtar

**Fjalët e panjohura:**

**Kanos:** kërcënoj, vë në rrezik...

**Shqotë:** shi me borë bashkë, shtrëngatë, stuhi

**18. Nëse poezitë kanë cilësi të njëjtat rretho PO, kurse nëse nuk i kanë rretho JO dhe argumentojë përgjigjen (sikurse në shembullin e dhënë).**

CILËSITË	TË NJËJTA	ARGUMENTIMI
Iloji i strofës	PO <b>JO</b>	Në vjershën " <i>Syrgjyn vdekur</i> " kemi një poezi të organizuar në strofa të quajtura katërshe që lidhen me rimë, kurse në poezinë " <i>Një mendim më turbullon</i> " nuk kemi një organizim të tillë dhe nuk ka rimë të rregullt.
gjinia letrare	PO JO	
Iloji letrar	PO JO	

2 pikë

**19. A) Nga poezia *Syrgjyn vdekur* përshkruaje antitezën apo kontrastin.**

\_\_\_\_\_

1 pikë

**B) Nga poezia *Një mendim më turbullon* përshkruaje figurën e intonacionit poetik të pasthirmës.**

\_\_\_\_\_

1 pikë

**20.** Me 80 deri në 130 fjalë shkruaje një hartim në të cilin do të përshkruash talentin tënd të fshehur/hapur.

**Në hartim:**

→ Paraqite talentin tënd, përkatësisht interesimin tënd (p.sh. për sport, matematikë, fizikë, kimi, muzikë, shkrim, balet...).

→ Shkruaj si ndihesh derisa i punon detyrat nga matematika, ose vizaton në dhomën tënde, ose ushtron në sallën e sportit, ose stërvitesh në oborr..

→ Shkruaj për raportin që kanë bashkëmoshatarët tu, njerëzit ku jeton të cilët e vërejnë talentin tënd.

→ Shkruaj sa je i gatshëm/e gatshme të vazhdosh të punosh në kushte jo të volitshme (në zhurmë, në vend ku nuk ka mjaft dritë...) ose që lojën ose daljet t'ua lëshosh bashkëmoshatarëve që të bësh atë që dëshiron. Përshkruaje një situatë të tillë.

→ Shkruaj nëse të mbështesin/nuk të mbështesin prindërit, bashkëmoshatarët ose mjedisi në të cilin jeton ose si do të dëshiroje të mbështesin kur do të mësonin për çfarë je i/e talentuar.

**Kij kujdes për formën e hartimit, si dhe për rregullat drejtshkrimore dhe gramatikore. Shkruaj lexueshëm dhe respekto kërkesën për numrin e fjalëve +/- 10% (vlerësohet hartimi i cili ka nga 72 deri në 143 fjalë; nëse hartimi ka më pak se 72 fjalë NUK LEXOHE T FARE, kurse në fjalën e 143-të NDËRPRITET leximi).**

18 pikë

#### PLANI PËR SHKRIMIN E HARTIMIT

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---


---

---

---

A series of horizontal lines for writing, consisting of 10 solid lines at the top and 20 dashed lines below.










This image shows a sheet of primary-ruled paper. It features 20 horizontal lines. The top 15 lines are solid, followed by a section of 5 dashed lines, and the bottom 5 lines are solid. This layout is typical for teaching handwriting to children, where the dashed lines help guide letter height and placement.





**E PLOTËSON KOMISIONI PËR VLERËSIM**

Numri i përgjithshëm i pikëve të fituara në test: \_\_\_\_\_

Nota: \_\_\_\_\_

**KOMISIONI:**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**VLERËSUESI KRYESOR:** \_\_\_\_\_

Data \_\_\_\_\_ 2017